



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 245/3 prot.

Tiranë më 15.2.2018

**REKOMANDIM**

Nr. 05, datë 15.2.2018

**MBI**

**ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.**

Baza Ligjore: Ligji nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Ligji nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit nr.45 datë 30.01.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Përmbaruesi Gjyqësor Privat - "Petani Bailiff's Office" shpk, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Përmbarues Gjyqësor Privat - "Petani Bailiff's Office" shpk.

Në funksion të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Zyrat Përmbarimore Private, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe përmbarues gjyqësor" dhe "subjekte që marrin pjesë në ekzekutim".

Kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor Privat - "Petani Bailiff's Office" shpk, është subjekt juridik me NIPT: L02401505K dhe objekt aktiviteti "Shërbim përmbarimor privat".

Kontrolluesi, në ushtrim të detyrës së tij, ka kryerjen e shërbimit përmbarimor privat gjyqësor dhe konkretisht ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Përfaqësuesi i kontrolluesit u njoh me Urdhrit nr. 45 datë 30.01.2018 të Komisionerit dhe ishte bashkëpunues me grupin e inspektimit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, në datë 30.01.2018 u konstatua se:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi disponon rregullorë për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar "*Deklaratë Konfidencialiteti*" për punëmarrësit që kanë akses në të dhëna personale.  
Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.
4. Kontrolluesi mbikëqyr nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) ambientet në të cilat ushtron aktivitetin si hyrjen, koridore dhe zyra. Koha e ruajtjes së të dhënave imazhe-video në sistemin e video-vëzhgimit (CCTV) është 15 ditë. Konstatohet që subjektet e të dhënave informohen nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).  
Konstatimi në lidhje me mbikëqyrjen e zyrave nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) përbën shkelje administrative të nenit 5 ("*1/b - në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime*"), nenit 6 (Kriteret ligjore për përpunimin) të Ligjit si dhe Udhëzimit nr.11 datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi "*Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*": "**10.2-Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës. Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret në tualete, dhomat e ndërrimit apo vende të tjera të ngjashme, ose në dhomat e punës të caktuara për përdorim personal të punonjësve**".
5. Konstatohet se kontrolluesi ka vendosur politikat e privatësisë në portalin zyrtar <http://www.petanilawfirm.al>.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi proces verbalin, i cili u lexua në prani të palëve dhe u nënshkrua pa vërejtje.

Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit dhe ka rikuperuar pjesërisht në mënyrë të menjëhershme disa nga konstatimet e grupit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor - "*Petani Bailiff's Office*" shpk të nënshkruaj "*Deklaratën e Konfidencialitetit*" me punëmarrësit që kanë akses në të dhëna personale.

2. Në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor - "Petani Bailiff's Office" shpk:
  - a. Të ndalojë mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-survejjimit në zyrat e administratës;
  - b. Të mos përdorë kamera dhe të shkatërrojë të gjitha të dhënat personale imazhe-video të cilat ndodhen në sistemin e video-survejjimit (CCTV), të regjistruara nga kamerat e vendosura në zyrat e administratës.
3. Kontrolluesi Përmbarues Gjyqësor Privat - "Petani Bailiff's Office" shpk, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 15. 2 .2018

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

